



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri
Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Për: **Gjykatësin e Procedurës Paraprake**
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 18 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Version i redaktuar publik i 'Kërkesës së dytë për paraqitjen e materialeve
mbështetëse shtesë', parashtrimi KSC-BC-2020-06/F00012 i datës 29 korrik 2020**

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Dejvid Hupër

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses të Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

1. Më 24 prill 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') kërkoi nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që të konfirmojë aktakuzën kundër Hashim THAÇIT, Kadri VESELIT, Rexhep SELIMIT, dhe Jakup KRASNIQIT ('Aktakuza').¹
2. Së bashku me Aktakuzën, dhe në pajtim me rregullën 86(3),² ZPS-ja paraqiti materiale provash mbështetëse.³ Materialet mbështetëse përfshinin transkriptime të një interviste të ZPS-së me Hashim THAÇIN të zhvilluar më 13-14 janar 2020.⁴ Në atë intervistë, z. THAÇI, ndër të tjera, (i) pranoi se kishte qenë i pranishëm në [REDAKTUAR] në kohën e ndalimit dhe keqtrajtimit të [REDAKTUAR]⁵ (ii) pranoi se e kishte ditur që [REDAKTUAR] ishin rrahur,⁶ dhe (iii) konfirmoi një komunikatë se ishte lëshuar në emër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.⁷
3. Pasi u kontaktua nga mbrojtësi i z. THAÇI pas bërjes publike të faktit se ishte ngritur aktakuzë kundër klientit të tij, ZPS-ja zhvilloi një tjetër intervistë me z. THAÇI më 13-16 korrik 2020. Gjatë intervistës, z. THAÇI dha në dukje një sërë 'sqarimesh' në lidhje me intervistën e mëhershme, dhe iu përgjigj pyetjeve shtesë të ZPS-së. Ndërmjet mohimeve të tjera të përgjithshme, z. THAÇI deklaroi, ndër të tjera, se: (i) nuk kishte pasur shërbim të zbulimit në UÇK,⁸ dhe (ii) as Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së e as Qeveria e Përkohshme nuk kishin qenë kurrë funksionale, por kishin ekzistuar vetëm

¹ Parashtrimi i Aktakuzës për konfirmim, KSC-BC-2020-06/F00002, 24 prill 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (me tri shtojca). Në përputhje me urdhrin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, aktakuza e rishikuar u parashtrua më 24 korrik 2020 (KSC-BC-2020-06/F00011, Parashtrimi i Aktakuzës së rishikuar për konfirmim, 24 korrik 2020, rreptësisht Konfidencial dhe *ex parte*).

² Rregullorja e Procedurës dhe e Provave Para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ('Rregullorja'). Përveç nëse është bërë e ditur ndryshe, të gjitha referencat për 'rregulla' ose 'rregullat' janë për Rregulloren.

³ *Shih gjithashtu* Vendim mbi kërkesën e Prokurorit të Specializuar për paraqitjen e materialit mbështetës shtesë, KSC-BC-2020-06/F00007, 17 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Vendim për materialin shtesë').

⁴ [REDAKTUAR].

⁵ [REDAKTUAR], f. 12.

⁶ [REDAKTUAR], f. 16-17; [REDAKTUAR], f. 1-4.

⁷ [REDAKTUAR], f. 10.

⁸ [REDAKTUAR], f. 6; [REDAKTUAR], f. 3; [REDAKTUAR], f. 2 (ku pretendon se madje as nuk e di nëse komponenti i zbulimit ka qenë pjesë e organigramës së UÇK-së); [REDAKTUAR], f. 14.

në letër.⁹ Z. THAÇI gjithashtu ofroi një version të ndryshëm të dijenisë së tij për ngjarjet në [REDAKTUAR], duke deklaruar së pari se kishte qenë në dijeni vetëm për pretendime të [REDAKTUAR],¹⁰ e më tej se nuk kishte qenë i informuar për ndonjë lëndim të shkaktuar ndaj tyre,¹¹ dhe duke deklaruar se, gjithsesi ai mësoi se atyre nuk u kishte ndodhur asgjë.¹²

4. Mohimet dhe parashtrimet në dukje të pabesueshme që po bëhen tani nga z. THAÇI – shumica prej të cilave kundërshtohen drejtpërdrejtë nga provat – nuk duhet të besohen. Sidoqoftë, është në interes të drejtësisë që deklarata e tij t'i jepet Gjykatësit të Procedurës Paraprake për vlerësim në dritën e materialit të paraqitur më herët.

5. Rrjedhimisht, në përputhje me rregullën 86(4)(a),¹³ ZPS-ja kërkon leje që të paraqesë një sasi të vogël materiali mbështetës shtesë, që përmban: (i) transkriptimet e intervistave të z. THAÇI me ZPS-në nga 13-16 korrik 2020,¹⁴ dhe (ii) kopjet e dokumenteve të diskutuara gjatë intervistës (ato që nuk janë paraqitur më parë).¹⁵

⁹ [REDAKTUAR], f. 9-11; [REDAKTUAR], f. 6; [REDAKTUAR], f. 5, 9; [REDAKTUAR], f. 9, 13; [REDAKTUAR], f. 8-9; [REDAKTUAR], f. 11; dhe [REDAKTUAR], f. 1, 8.

¹⁰ [REDAKTUAR], f. 9-17.

¹¹ [REDAKTUAR], f. 15-17 dhe 20-21 (ku pretendon se kur i kanë thënë se po ndodhnin gjëra të këqija, ai i kishte lidhur me bombardimet nga Serbia, e jo që kishin të bënin me [REDAKTUAR]).

¹² [REDAKTUAR], f. 16-17 (ku pretendon se faktikisht nuk kishte ndodhur çfarë i kishin thënë se po ndodhte).

¹³ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave Para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ('Rregullorja'). Përveç nëse është bërë e ditur ndryshe, të gjitha referencat për 'rregulla' ose 'rregullat' janë për Rregulloren.

¹⁴ [REDAKTUAR].

¹⁵ Këto dokumente përmenden në intervistë si Provat materiale 16-54. Këto dokumente tashmë janë paraqitur si materiale mbështetëse; vetëm ato që nuk janë paraqitur më parë janë objekt i kësaj kërkesë. Prova materiale 16: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] (e paraqitur më parë); Prova materiale 17: [REDAKTUAR]; Prova materiale 18: [REDAKTUAR] (e paraqitur më parë); Prova materiale 19: [REDAKTUAR]; Prova materiale 20: [REDAKTUAR] (e paraqitur më parë); Provat materiale 21 dhe 22: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]; Prova materiale 23: [REDAKTUAR] at [REDAKTUAR] (e paraqitur më parë) dhe [REDAKTUAR]; Provat materiale 24 dhe 25: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] (të paraqitura më parë); Prova materiale 26: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]; Provat materiale 27 dhe 28: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]; Prova materiale 29: [REDAKTUAR]; Prova materiale 30: [REDAKTUAR] (e paraqitur më parë) dhe [REDAKTUAR] (e paraqitur më parë); Prova materiale 31: [REDAKTUAR]; Prova materiale 32: [REDAKTUAR]; Prova materiale 33: [REDAKTUAR]; Prova materiale 34: [REDAKTUAR] (e paraqitur më parë); Prova materiale 35: [REDAKTUAR]; Prova materiale 36: [REDAKTUAR] (e paraqitur më parë); Provat materiale 37 dhe 38: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]; Provat materiale 39 dhe 42: [REDAKTUAR] (me referenca të faqeve: ballina dhe [REDAKTUAR] (e paraqitur më parë); Prova materiale 40: [REDAKTUAR]; Prova

Këto materiale shitesë janë bërë të disponueshme¹⁶ vetëm kohët e fundit, kanë shtrirje dhe vëllim të kufizuar,¹⁷ dhe – duke përfshirë deklaratë të mëtejshme të njërit nga të dyshuarit – kanë lidhje me akuzat.¹⁸

6. Ky parashtrim është rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* në pajtim me rregullat 85(4) dhe 86(2).

Numri i fjalëve: 912 (në origjinal)

/nënshkrimi/

Xhek Smith

Prokurori i Specializuar

E mërkurë, 18 nëntor 2020
Në Hagë, Holandë.

materiale 41: [REDAKTUAR]; Prova materiale 43: [REDAKTUAR] (e paraqitur më parë); Prova materiale 44: [REDAKTUAR]; Provat materiale 45 dhe 46: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]; Prova materiale 47: [REDAKTUAR]; Prova materiale 48: [REDAKTUAR]; Prova materiale 49: [REDAKTUAR]; Prova materiale 50: [REDAKTUAR]; Prova materiale 51: [REDAKTUAR]; Prova materiale 52: [REDAKTUAR] (Përkthim i ZPS-së; pikëshënuesi është hequr padashur); Prova materiale 53: [REDAKTUAR]; Prova materiale 54: [REDAKTUAR].

¹⁶ Vendim për materialin shitesë, KSC-BC-2020-06/F00007, para. 8.

¹⁷ Vendim për materialin shitesë, KSC-BC-2020-06/F00007, para. 7.

¹⁸ Vendim për materialin shitesë, KSC-BC-2020-06/F00007, para. 8.